

REZULTATET E ANKETËS SË BUXHETIT TË FAMILJEVE NË SHQIPËRI 2006-2007

Të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes 2006-07, realizuar nga INSTAT mbi një kampion prej 6025 familjesh, bëjnë të mundur përshkrimin e shpenzimeve për konsum të familjeve shqiptare.

Në periudhën e referencës shpenzimet mesatare mujore të familjeve vlerësohen në shifrën 69 mijë lekë duke pasur parasysh se një familje në Shqipëri përbëhet mesatarisht nga 4 persona. Shuma totale e shpenzimeve mujore të familjeve shqiptare, që vlerësohet të jenë rreth 752 mijë familje, arrin në 52 miliardë lekë në muaj.

Nëse konsiderojmë shpenzimet mesatare mujore për frymë në periudhën një-vjeçare të kryerjes së anketës, rezulton se një individ në Shqipëri shpenzon mesatarisht rreth 17 mijë lekë në muaj nga të cilat 9 mijë lekë për konsum ushqimor dhe 8 mijë lekë për konsum jo-ushqimor.

Një përpjekje për të krahasuar evolucionin e konsumit nga viti 1999-2000, kur është kryer anketa paraardhëse e buxhetit të familjes por vetëm për zonën urbane të Shqipërisë, në krahasim me përfshirjen totale të territorit të vendit në 2006-2007, nxjerrim si rezultat se konsumi mesatar mujor për frymë ka pasur një rritje prej rreth 2.2 herë. Duke patur parasysh që inflacioni është rritur 23.2% në periudhën 2000-2007, arrijmë në konkluzionin se shpenzimet reale për frymë janë rritur rreth 1.8 herë.

Metodologjia e Anketës:

Anketa e Buxhetit të Familjes u krye nga INSTAT gjatë periudhës 1-vjeçare: Tetor 2006 - Shtator 2007. Në përfundim të vrojtimit rezultuan rreth 5600 familje të intervistuar, të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë. Kampionimi u krye me dy hapa, ndër të cilët i pari me stratifikim: stratifikimi bazohet në 12+1 prefektura të Shqipërisë*, njësitë e hapit të parë janë zonat e regjistrimit të uniformizuara ndërsa njësitë e hapit të dytë janë familjet. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastit duke siguruar një përfaqësim si përsa i përket nivelit: prefekturë ashtu dhe zonës së vendbanimit qytet-fshat. Totali i familjeve të kampionuara u nda në 4 nën-kampione tre-mujore të cilët u shpërndanë gjeografikisht në mënyrë homogjene gjatë gjithë vitit, për të bërë të mundur pasqyrimin e ndryshimeve stinore. Si rrjedhim janë anketuar çdo muaj rreth 475 familje të shpërndara njëtrajtësisht në të gjitha zonat e zgjedhura, që siguron përfaqësimin e çdo zone në të gjithë muajt e vitit.

Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:

- Plotësimi i një ditari nga ana e familjeve për 14 ditë në vazhdim ku regjistrohen shpenzimet për blerje produktesh/shërbimesh të konsumit të gjerë si dhe, sa herë që plotësohen kushtet, plotësimi i një ditari të veçantë për autokonsum ku familja regjistron vetëm produktet e prodhuara dhe të konsumuara gjatë 14 ditëve të referencës, vlerësuar me çmimin që do të kishte paguar për t'i blerë në dyqanin më të afërt.

- Kryerja e një interviste direkte (gojore) nga anketuesit nëpërmjet një pyetsori ku përfshihen pyetje mbi shpenzimet me vlerë më të madhe dhe me frekuencë blerjeje më të rrallë, të grupuara dhe të ndara sipas temave të veçanta. Në të njëjtin pyetsor janë përfshirë edhe pyetjet mbi të dhënat socio-demografike të komponentëve të familjes që do të shërbejnë gjatë analizës së buxhetit familjar sipas tipologjive të familjeve.

Shkalla e përgjigjes rezultoi 94.4 për qind.

Në këtë dokument janë paraqitur të dhëna mbi të gjitha shpenzimet për konsum të familjeve për blerje produktesh dhe shërbimesh me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qerasë së imputuar.

Tabela 1. Konsumi mujor për familje dhe për frymë dhe struktura e tij në %, 2006-2007


Grupet e medha te konsumit	Shpenzimet mujore ne leke		Struktura e konsumit (ne %)
	familje	fryme	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	33,003	8,251	47.6
Pije alkoolike, duhan	3,011	753	4.3
Veshje dhe kepuce	4,297	1,074	6.2
Banesa	5,109	1,277	7.4
Mobilim, pajisje shtepiake dhe mirembajtje te zakonshme te baneses	4,081	1,020	5.9
Shendet	2,845	711	4.1
Transport	4,332	1,083	6.2
Komunikim	2,044	511	2.9
Argetim dhe kulture	2,162	540	3.1
Arsim	1,191	298	1.7
Restorante dhe hotele	3,482	870	5.0
Te tjera mallra dhe sherbime	3,826	956	5.5
Konsumi gjithsej	69,383	17,346	100.0

Struktura e konsumit të familjeve shqiptare është paraqitur sipas ndarjes në 12 grupet bazë të konsumit (klasifikimi COICOP), Grafik 1. Në ndryshim nga shpenzimet totale të familjeve për konsum, struktura apo përqindja e buxhetit familjar nuk ndryshon në mënyrë të ndjeshme krahasuar me strukturën që rezulton nga ABF 1999-2000 në zonat urbane.

Ushqimi (pa përfshirë pijet alkoolike) mbetet një element i rëndësishëm në buxhetin familjar duke zënë 47.6 për qind të tij. Në këtë grup, peshën më të madhe e zë shpenzimi për “mish dhe nënprodukte” që përbën rreth 22.5 për qind të buxhetit brenda grupit. Produktet që vijnë më pas për nga vlera e shpenzuar janë “qumështi, vezët dhe nënproduktet e tij” (me një peshë prej 16.1 për qind) si dhe “bukë dhe drithëra” (15.5 për qind). Nëngrupet që vijnë më pas janë perimet që zënë 14 për qind të grupit kryesor dhe frutat që zënë 8.8 për qind.

Përsa i përket grupit pije alkoolike dhe duhan, rezulton se në familjet shqiptare konsumohet për to rreth 4.3 për qind e buxhetit, ku vetëm duhani zë një peshë prej 50.6 për qind brenda grupit. Konsumi jashtë shtëpisë, në fast food, bar dhe hotele/restorante, përbën 5 për qind të buxhetit të familjeve shqiptare.

Grafik 1: Struktura e konsumit, 2006-2007



Një rritje në krahasim me 1999-2000, përsa i përket kuotës së shpenzimeve totale që familjet i dedikojnë kujdesit për shëndetin si dhe komunikacionit, paraqesin grupet “Kujdes shëndetësor” dhe “Komunikim” ku peshën më të madhe e zënë përkatësisht: blerja e medikamenteve me rreth 71.4 për qind dhe shpenzimet për shërbime telefonie me 92.5 për qind brenda grupeve përkatës. Po me rritje, megjithëse në një shkallë më të vogël, paraqitet grupi “Veshje dhe këpucë” i cili zë 6.2 për qind të konsumit total. Brenda këtij grupi, veshjet zënë një peshë prej rreth 68 për qind ndërsa zëri “këpucë dhe të ngjashme” 26 për qind.

Grupi “Banesa” me shpenzimet për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qera të paguar efektivisht dhe riparime të vogla zë 7.4 për qind të totalit të buxhetit familjar. Rreth 44 për qind e këtyre shpenzimeve shkojnë për pagesën e energjisë elektrike dhe 27.4 për qind për ngrohje, ndërsa 7.8 për qind shkojnë për shpenzimet për qera. Duhet të theksojmë se përqindja e familjeve që deklarojnë se paguajnë aktualisht qera për banesën e tyre është mjaft e ulët, vetëm 3.4 për qind.

Grupi “Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës” paraqet një stabilitet në strukturën e shpenzimeve totale, rreth 6.3 për qind brenda të cilit artikujt shtëpiakë jo-afatgjatë kanë një peshë që zë me shumë se gjysmën e shpenzimeve (rreth 60 për qind).

Ndër grupet që paraqesin një ulje përsa i përket kuotës që zënë ndaj shpenzimeve totale, janë “arsimi” dhe “të tjera mallra dhe shërbime”.

Shpenzimet për arsim zënë 1.7 për qind të buxhetit gjithsej. Brenda këtij grupi pagesat në lidhje me arsimin e lartë zënë 62.6 për qind.


Shpenzimet që familjet shqiptare i dedikojnë grupit “të tjera mallra dhe shërbime” zënë një peshë prej 5.5 për qind të buxhetit total. Në këtë grup përfshihen: “shpenzime për kujdes personal”, “shpenzime të jashtëzakonshme të kryera nga familjet në raste ceremonish dhe festash”, “pagesat për shërbime të ndryshme financiare private” si dhe “sigurimet”. Brenda grupit, zëri “artikuj dhe produkte për kujdes personal” zë peshën më të madhe, rreth 54 për qind. Shpenzimet e përfshira në grupin “transport” zënë 6.2 për qind të totalit. Peshën më të madhe brenda grupit e përbëjnë shpenzimet që i referohen lëvizjes me mjete publike apo private, si “shpenzime për transport rrugor”, rreth 32 për qind dhe “karburant dhe lubrifikantë” me 40.3 për qind ndjekur nga zërat “pjesë këmbimi dhe aksesore” (11.2 për qind) si dhe “mirëmbajtje dhe

riparime” (9.2 për qind). Shifrat e fundit tregojnë për një peshë gjithnjë e më të rëndësishme të shpenzimeve për mjete të transportit privat ndaj totalit të transportit në përgjithësi.

Konsumi sipas prefekturave

Anketa e Buxhetit të Familjes mundëson analizën e të dhënave statistikore në 12+1 prefektura.

Tirana paraqet konsumin më të lartë në vlerë krahasuar me të gjitha prefekturat e tjera, një familje e kryeqytetit shpenzon mesatarisht në muaj 83,800 lekë. Prefekturat që paraqesin shpenzimet më të larta për konsum, pas Tiranës, janë Durrësi dhe Gjirokastra me konsum mujor familjar përkatësisht 82,900 dhe 82,815 lekë. Prefektura me nivel më të ulët të shpenzimeve për konsum është ajo e Dibrës dhe e Beratit përkatësisht me 51,300 dhe 54,100 lekë në muaj për familje.




Konsumi sipas rajoneve

Realizimi për herë të parë i Anketës së Buxhetit të Familjes në Shqipëri edhe në zonën rurale bën të mundur krahasimin e nivelit të konsumit të kësaj zone me atë urbane.

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e konsumit të familjeve shqiptare sipas zonave të vendbanimit.

Niveli i konsumit te shpenzimeve sipas zonave



Kuota më e lartë e buxhetit total të familjeve, shpenzimet ushqimore, arrijnë në 49.5 për qind në zonën rurale kundrejt 45.8 për qind në zonën urbane.


Në zonën rurale kuota e shpenzimeve për pije alkoolike dhe duhan është më e lartë se në zonën urbane, 4.9 për qind kundrejt vetëm 3.8 për qind. Megjithatë, shpenzimet për hotele dhe restorante zënë një peshë më të vogël në buxhetin e familjeve rurale në krahasim me ato urbane, përkatësisht 4.8 kundrejt 5.2 për qind.

Zona rurale paraqet përqindje më të lartë të shpenzimeve për transport: 6.7 për qind kundrejt 5.8 për qind në zonat urbane. Gjithashtu, në zonën rurale vihen re shpenzime më të larta në përqindje ndaj totalit, te grupeve: kujdes shëndetësor, 4.4 për qind kundrejt 3.8 për qind në zonat urbane si dhe mirëmbajtje dhe mobilim i banesës, 4.4 kundrejt 3.8 për qind.

Zona urbane konsumon më shumë për sherbimet e banesës: 8.2 për qind kundrejt 6.4 për qind në zonat rurale; për komunikim: 3.5 kundrejt 2.3 për qind; arsim: 2.3 kundrejt vetëm 1.0 për qind; argëtim dhe kulturë 3.5 kundrejt 2.7 për qind si dhe për të tjera mallra dhe sherbime 6.1 kundrejt 4.9 për qind.

Shpërndarja e shpenzimeve të konsumit gjithsej sipas Kurbës së Lorenzit

Grafik 3 Shpërndarja e shpenzimeve gjithsej midis familjeve



Një analizë e shpërndarjes së nivelit të shpenzimeve për konsum tregon se 90 për qind e familjeve shqiptare arrijnë në rreth 77 për qind të vlerës së konsumit total të popullatës duke shpenzuar mesatarisht rreth 60 mijë lekë në muaj. Pra, vetëm 10 për qind e familjeve në Shqipëri shpenzon rreth 23 për qind të totalit duke konsumuar rreth 153 mijë lekë në muaj për familje. Këto rezultate në terma unitarë (konsumi mujor mesatar për frymë) tregojnë për një disnivel në Shqipëri: shumica e popullsisë që korrespondon me 90% të familjeve shpenzon rreth 16 mijë lekë në muaj, ndërsa një pjesë mjaft e vogël që korrespondon me 10% të familjeve shpenzon rreth 52 mijë lekë në muaj ose 3 herë më shumë.

Shpërndarja e shpenzimeve të konsumit sipas tipit të familjes .

Niveli dhe struktura e shpenzimeve për konsum ndryshojnë në varësi të madhësisë dhe përbërjes familjare që ndikojnë në mënyrën e alokimit të buxhetit të disponueshëm.

Familjet e përbëra nga një person i vetëm dhe çiftet pa fëmijë, shpenzojnë më shumë për ushqim krahasuar me tipet e tjera të familjeve. Gjithashtu familjet me një person të vetëm dhe çiftet pa fëmijë shpenzojnë më shumë se tipet e tjera të familjeve për kujdes shëndetsor dhe për banesën. Kjo vjen për arsye se familjet më të mëdha në numër përfitojnë dhe nga efekti i ekonomive të shkallës për këto zëra.

Ndërsa shpenzimet për arsim ose për veshje dhe këpucë janë më të larta në familjet me 1, 2 dhe 3 fëmijë. Po kështu prezenca e fëmijëve sjell shpenzime më të larta në transport, komunikim si dhe në zërin restorante dhe hotele.

Një pasqyre e shperndarjes së buxhetit sipas tipologjive familjare paraqitet në tabelën e mëposhtme.

	Tipi i familjes							
	Person i vetem	Cift pa femije	Cift me nje femije	Cift me dy femije	Cift me 3+ femije	Monoprind me nje femije	Familje tjeter	Gjithsej
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	54.2	51.7	46.4	45.4	49.2	49.9	47.1	47.6
Pije alkoolike, duhan	4.3	5.1	4.6	4.0	4.4	3.5	4.4	4.3
Veshje dhe kepuce	3.9	3.4	5.9	6.7	7.1	6.2	6.2	6.2
Banesa	9.6	8.7	8.1	7.4	7.3	7.3	6.7	7.4
Mobilim,pajisje shtepiake, mirembajtje banese	5.7	6.2	5.5	6.0	5.8	6.4	5.8	5.9
Shendet	6.7	6.2	3.6	3.3	3.3	4.2	4.7	4.1
Transport	2.4	4.4	5.7	6.2	6.9	3.6	7.1	6.2
Komunikim	2.0	3.0	3.3	3.3	2.5	2.9	2.9	2.9
Argetim dhe kulture	1.9	2.4	2.9	3.4	3.3	2.9	3.1	3.1
Arsim	0.0	0.1	2.3	2.7	1.6	2.3	1.3	1.7
Restorante dhe hotele	5.5	3.7	6.1	5.9	3.6	4.5	5.1	5.0
Te tjera mallra dhe sherbime	3.7	5.0	5.5	5.8	5.0	6.4	5.7	5.5
Konsumi tot.	100	100	100	100	100	100	100	100

* 12 prefekturat: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë. Fier i referohen ndarjes administrative më të re të territorit shqiptar ndërsa Lushnja, është konsideruar nje stratë më vete.